



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 1207 / prot  
12

Gramsh, më 26 02.2019

**Vendim**

Nr. 15, dt. 25 02.2019

**Për përballimin e shpenzimeve të varrimit dhe varrosjen e të ndjerës Bukurie Shyqyri Kullolli në varrezat publike të qytetit.**

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të dates 25 02.2019 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjenca civile "Për përballimin e shpenzimeve të varrimit dhe varrosjen e të ndjerës Bukurie Shyqyri Kullolli në varrezat publike të qytetit", në mbështetje të ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", të ndryshuar, të VKB nr.99, datë 18.12.2017 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundervajtjet administrative", si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, pika 7, neni 8, pika 2;

**V e n d o s i:**

- I. Të miratojë varrimin e të ndjerës Bukurie Shyqyri Kullolli, në varrezat publike të qytetit Gramsh.
- II. Të miratojë shpenzimet për varrimin e të ndjerës Bukurie Shyqyri Kullolli, në shumën 81 780 lekë me tvsh nga buxheti i bashkisë
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetari i bashkisë, drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjenca civile, firma sipërmarrëse Kurora shpk.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Astrit DUZHA

Konc. dak. A. Duzha

Pranoi : Sh. Hoxha

Konfirmoi Sh. Hoxha

Dosja nr. \_\_\_\_\_

Afati \_\_\_\_\_



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Shkëlqim HOXHA